



DOKUMENT I POLITIKAVE PUBLIKE

***“DREJT POLICISË LLOGARIDHËNËSE
NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT”***

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

351.741:005.332.5(497.7)(047.31)

STOJANOVSKI, Aleksandar

Drejt policisë llogaridhënëse në Republikën e Maqedonisë së Veriut
[Електронски извор] : dokument i politikave publike / [autorë Aleksandar
Stojanovski, Kristina Angelevska, Dimitar Nikollovski ; përkthimi
maqedonisht - shqip Behar Rushit]. - Shkup : Qendra e strategjive
europiane Eurothink, 2022

Начин на пристапување (URL):

<https://eurothink.mk/wp-content/uploads/2022/06/DOKUMENT-I-POLITIKAVE-PUBLIKE-DREJT-POLICISE-LLOGARIDHENESE-NE-REPUBLIKEN-E-MAQEDONISE-SE-VERIUT.pdf>.

- Превод на делото: Кон отчетна полиција во Република Северна Македонија
: документ за јавни политики. - Текст во PDF формат, содржи 21 стр.,
илустр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден
08.06.2022

ISBN 978-608-4923-51-0

1. Angelevska, Kristina [автор] 2. Nikollovski, Dimitar [автор]
а) Полиција -- Транспарентност -- Македонија -- Истражувања

COBISS.MK-ID 57558789

Botues:

EUROTHINK - Qendra e Strategjive Europiane - Shkup

Rreth botuesit (Redaktues):

Dimitar Nikollovski, drejtor ekzekutiv

Autorë:

Aleksandar Stojanovski, Kristina Angelevska, Dimitar Nikollovski

Rregullimi grafik:

Sashka Deskoska

Përkthimi Maqedonisht - Shqip:

Behar Rushit

Titulli i origjinalit:

Документ за јавни политики

„КОН ОТЧЕТНА ПОЛИЦИЈА ВО РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА“

Viti 2022

*Botimi është përgatitur në kuadër të projektit “**Drejt policisë transparente, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në Republikën e Maqedonisë së Veriut**”, i zbatuar nga EUROTHINK – Qendra e Strategjive Europiane dhe i mbështetur financiarisht nga National Endowment for Democracy of the United States of America.*

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e National Endowment for Democracy të Shteteve të Bashkuara të Amerikës ose të partnerëve të saj.

PËRMBAJTJA

- 01 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 5
- 02 SHËNIM METODOLOGJIK MBI AKTIVITETET HULUMTUESE TË PROJEKTIT 6
- 03 REKOMANDIMET 7
- 04 LLOGARIDHËNIA NË PUNËN POLICORE 9
- 05 IKONTROLI I BRENDSHËM I PUNËS POLICORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT 13
- 06 KONTROLI I JASHTËM I PUNËS POLICORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT 16
- 07 KONKLuzionET 19

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Projekti “Drejt policisë transparente, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në Republikën e Maqedonisë së Veriut” zbatohet me qëllim që të kontribuojë në punën më të mirë të policisë dhe rritjen e besimit në policinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Ky synim i projektit synohet të arrihet duke vlerësuar shkallën e llogaridhënies, transparencës dhe nivelin e vendimmarrjes gjithëpërfshirëse në punën e policisë në nivel kombëtar. Për më tepër, qëllimi përfundimtar i kësaj sipërmarrjeje njëvjeçare është nxitja e dialogut ndërmjet policisë, medieve dhe organizatave të shoqërisë civile në nivel lokal, me shpresë se do të kontribuojë në debatin publik për siguri më të madhe në shoqërinë e Maqedonisë së Veriut.

SHËNIM METODOLOGJIK MBI AKTIVITETET HULUMTUESE TË PROJEKTIT

Matja e opinionit publik

Anketa telefonike e kryer në periudhën nga 23 deri më 30 nëntor të vitit 2021 nga BRIMA, në një mostër përfaqësuese prej 1001 të anketuarish, me gabim të vogël +3%, nëpërmjet metodës CATI.

Diskutimet e grupeve të fokusit me qytetarët

Në periudhën nga dhjetori 2021 deri në mars 2022 janë zhvilluar tetë diskutime në grupet e fokusit me 49 qytetarë, nga të cilët 28 ishin femra dhe 21 meshkuj. Grupet e fokusit janë bërë në qytetet: Shkup, Kumanovë, Tetovë, Strugë, Manastir, Shtip, Strumicë dhe Veles.

Intervistat me nëpunësit policorë

Në periudhën nga nëntori 2021 deri në mars 2022 janë kryer 33 intervista me nëpunës policorë nga të tetë sektorët e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Kërkesat për qasje në informacionet me karakter publik

Në periudhën dhjetor 2021 deri në prill 2022, 92 kërkesa për qasje në informacionet me karakter publik janë dërguar në 84 institucione publike qendrore dhe lokale (të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale, MPB, Avokati i Popullit, Prokuroria Publike e Ndjekjes së Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit).

REKOMANDIMET

Drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme:

- Edhe pse nuk është palë në procedurën penale individuale, është e leverdishme që Sektori i Kontrollit të Brendshëm, Hetimeve Penale dhe Standardeve Profesionale të përdorë nenin 126 të Ligjit të Procedurës Penale dhe të dokumentojë/monitorojë rezultatin e rasteve penale kundër nëpunësve policorë dhe personave zyrtarë;
- Të monitorojë dhe analizojë rregullisht praktikën juridike që rrjedh nga rastet e keqpërdorimit policor të trajtuara nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, me vëmendje të veçantë në rastet në të cilat Republika e Maqedonisë së Veriut paraqitet si palë;
- Të informojë publikun në mënyrë të plotë dhe të rregullt për veprimet e Sektorit të Kontrollit të Brendshëm, Hetimet Penale dhe Standardet Profesionale në lidhje me procedurat e përfunduara disiplinore, kallëzimet penale të ngritura, rezultatin e gjykimeve penale, me qëllim përmirësimin e imazhit dhe perceptimit publik të punonjësve në ministri për funksionimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm në luftën kundër dukurive devijuese dhe joetike në radhët e tyre;
- Të vendosë në publik informacion se çfarë trajnimi dhe edukimi kanë/marrin nëpunësit policorë, për të reduktuar apo parandaluar devijimet në punë.

Tek mekanizmat e jashtëm të kontrollit të punës policore: Avokati i Popullit dhe Njësia e Specializuar e Hetimit dhe Ndjekjes së Krimeve të kryera nga personat me kompetenca policore dhe pjesëtarë të policisë së burgjeve:

- Të rritet dukshmëria e tyre dhe të kujdeset për promovimin më të madh të tyre në publik, gjë që do të rriste vetëdijen e qytetarëve për ekzistimin e këtyre mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Publiku është kryesisht i pavetëdijshëm se këto mekanizma të jashtëm ekzistojnë dhe janë funksionale.

Drejtuar qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile aktive në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut:

- Organizatat relevante dhe aktive të shoqërisë civile në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të vazhdojnë të punojnë me intensitet të shtuar për të përfituar nga mundësitë e ofruara nga mekanizmat ekzistues të brendshëm dhe të jashtëm për të kontrolluar punën policore përmes promovimit publik dhe ofrimit të ndihmës për grupet e cënueshme të trajtimit çnjerëzor dhe mizor nga zyrtarët me kompetenca policore;
- Të rrisin aktivitetin e tyre në përdorimin e mekanizmit të brendshëm në kuadër të MPB-së dhe mekanizmave të jashtëm për mbrojtjen e të drejtave individuale dhe grupore në rastet kur ka tregues për tejkalim të autorizimeve dhe keqpërdorim të pozitës zyrtare nga nëpunësit policorë, personat me kompetenca policore dhe burgu policor.

Drejtuar mediave dhe punonjësve mediatikë:

- Si pjesë e rëndësishme e shoqërive demokratike, mediat dhe punonjësit mediatikë duhet të monitorojnë me zell dhe aktivisht, si dhe të raportojnë për punën dhe sjelljen e organeve shtetërore dhe shërbimeve publike, përfshirë policinë. Të informojë publikun në mënyrë objektive dhe të paanshme për rastet e brutalitetit policor, shpërdorimit të detyrës, si dhe trajtimit dhe diskriminimit të pakujdesshëm ndaj individëve dhe grupeve të qytetarëve.

LLOGARIDHËNIA NË PUNËN POLICORE

Llogaridhënia e policisë do të thotë që puna policore - nga sjellja individuale e çdo nëpunësi policor te strategjitë e zhvillimit të policisë, procedurat e emërimit ose menaxhimi i buxhetit - mbikëqyrret nga një sërë institucionesh mbikëqyrëse. Institucionet mbikëqyrëse mund të përfshijnë organet ekzekutive (kontrolli politik dhe financiar dhe mbikëqyrja horizontale nga organet qeveritare), legjislaturat (deputetët, komisionet hetimore parlamentare), gjyqësorin, si dhe komisionet e të drejtave të njeriut dhe organet e shqyrtimit të padive të paraqitura nga qytetarët, përkatësisht prokuroritë publike apo Avokati i Popullit. Gjithashtu, mediat mund të luajnë rol të rëndësishëm në informimin e publikut për punën e policisë.¹

Me ardhjen e shoqërive dhe institucioneve demokratike, vetë qeveritë, por edhe shoqëria civile, në mënyrë aktive kërkojnë mënyra për të transformuar strukturat e policisë nga organe shtetërore që kanë shërbyer për kontrollin e qytetarëve në organe të administratës shtetërore që do të plotësojnë nevojat e qytetarëve. Prej këtui del teza se **policia duhet të jetë mbi të gjitha shërbim për qytetarët dhe jo aparat social i dhunës në vetvete**. Ekzistenca e formave të ndryshme të qeverisjes demokratike të shoqërive në realitet do të thotë se ato mishërohen përmes qasjeve të ndryshme të punës dhe strategjive të organizimit të policisë. Nga kjo mund të përfundojmë se nuk ka asnjë recetë të vetme apo ideale për organizimin e një organizate policore. Policia duhet të udhëhiqet gjithmonë nga parimi i sundimit të së drejtës. Duke vepruar kështu, ajo duhet të respektojë dhe mbrojë dinjitetin njerëzor, por edhe t'i kushtojë vëmendje të drejtave themelore njerëzore, civile dhe politike që i garantohen qytetarit.²

¹ “Doracak për punën policore demokratike nga Këshilltari i Lartë i Policisë së Sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së” [Прирачник за демократско полициско работење], Vjenë, maj 2008, edicioni i dytë, f. 33, <https://www.osce.org/files/f/documents/f/f/109907.pdf>

² Organizata e Sigurisë dhe Bashkëpunimit në Europë, ‘Guidebook on Democratic Policing’, by the Senior Police Adviser to the OSCE Secretary General, Vienna, 2008. <http://www.osce.org/spmu/23804>

Në teorinë e policisë në shoqëritë demokratike mund të vërehet se emëruesi i përbashkët i një policie demokratike janë tre aspekte: 1) profesionalizmi; 2) llogaridhënia, pra përgjegjësia; 3) legjitimiteti.³

Si postulat bazë i konceptit të sundimit të së drejtës, në shoqëritë demokratike policia është llogaridhënëse, përkatësisht përgjegjëse për veprimet e saj. Në kontekstin e sundimit të së drejtës, policia legjitimitetin e saj e fiton nëpërmjet zbatimit të ligjeve, pra sigurimit të normave juridike, në kundërshtim me zbatimin e ligjit si rezultat i interesave partiake.⁴

Llogaridhënia e policisë është kthyer në një nga temat më të rëndësishme me interes vitet e fundit dhe shoqërohet me rënien e besimit të publikut të “shteti”, ndaj hapja dhe transparenca po bëhen tipare shumë të pritshme dhe të kërkuara të këtij shërbimi publik.⁵

Fragment nga sondazhi i opinionit publik “Eurometri, dimër 2021”⁶

46% e të anketuarve të përfshirë në anketën telefonike janë të mendimit se policia nuk është llogaridhënëse (klasat 1 dhe 2) për punën e saj, ndërsa 20% e të anketuarve në mostër konsiderojnë është llogaridhënëse (klasat 4 dhe 5). Pothuajse një e treta, pra 32% e të anketuarve të përfshirë në mostër, e vlerësuan policinë si mesatarisht llogaridhënëse (klasa 3).

Mbikëqyrja në polici (por edhe në organet e tjera të administratës shtetërore) nënkupton: krahasimin e veprimtarisë reale të organizatës, pra të rezultateve të administratës (policisë) me rezultatet që prisnim në bazë të kritereve të paracaktuara⁷.

³ Marenin, Otwin. “Ndërtimi i komunitetit global për studimeve policore” [Building a Global Police Studies Community], *Police Quarterly* Vol. 8 (1), f. 99-136.

⁴ Atanasov, Petar. “Reforma policore në Republikën e Maqedonisë: Ndërmjet policimit komunal dhe policimit demokratik” [Police reform in the Republic of Macedonia: Between community policing and democratic policing]. *Annual of the Institute for Sociological, Political and Juridical Research* 2: f. 21-45

⁵ Service, Trevor. “Nga Belfasti në Bishkek: një perspektivë ndërkombëtare mbi policimin e fqinjësisë dhe komunitetit” [From Belfast to Bishkek: an international perspective on neighborhood and community policing], *International Journal of Police & Management*, Vol. 14 (4), f. 362-372.

⁶ Stojanovski, Aleksandar. “PERCEPTIMET DHE QENDRIMET E QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT MBI PUNËN E POLICISË - HULUMTIM I REALIZUAR PËR NEVOJAT E PROJEKTIT” [ПЕРЦЕПЦИИ И СТАВОВИ НА ГРАЃАНИТЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОИЈА ЗА РАБОТАТА НА ПОЛИЦИЈАТА - ИСТРАЖУВАЊЕ СПРОВЕДЕНО ЗА ПОТРЕБИТЕ НА ПРОЕКТОТ: Кон транспарентна, отчетна и инклузивна полиција во Република Северна Македонија], Eurothink – Qendra e Strategjive Europiane, Shkup, nëntor, 2021

⁷ Pusiq, Eugen. “Nauka o upravi” [Shkenca e Administratës], libër shkollor, Zagreb, 1993, f. 304., f. 304.

Prandaj, mbikëqyrja në polici mund të jetë:

- Mbikëqyrja e rezultateve të punës dhe mbikëqyrja e mënyrës së punës;
- Mbikëqyrja e përmbajtjes dhe mbikëqyrja e ekonomisë;
- Mbikëqyrja e ligjshmërisë dhe mbikëqyrja e përshtatshmërisë;
- Llojet e tjera të mbikëqyrjes, si mbikëqyrja e përgjithshme dhe e veçantë, mbikëqyrja e brendshme dhe e jashtme, mbikëqyrja e mëparshme dhe e mëvonshme.

Në anglisht, termi “control” përdoret për “mbikëqyrjen”, që në përkthim të lirë do të thotë: “kontrolli”.

Termi “mbikëqyrje” është i lidhur ngushtë me termin “përgjegjësi”, pra llogaridhënie. Në polici termi “përgjegjësi” ka kuptim më të gjerë dhe megjithëse ka shenjë negative, nuk nënkupton asnjë faj nga ana e atyre që janë përgjegjës për veprime të tilla.⁸

Roli i policisë në komunitet është të kujdeset për rendin dhe qetësinë publike, sigurinë, por në të njëjtën kohë, parandalimin e krimit, zbulimin dhe dokumentimin e krimeve. Format e reja të frikësimit dhe krimit kontribuojnë në propozimin dhe miratimin e kompetencave më të mëdha për policinë, duke forcuar vazhdimisht fuqinë e saj në komunitet, përfshirë edhe në shoqërinë demokratike.

forcuar vazhdimisht fuqinë e saj në komunitet, përfshirë edhe në shoqërinë demokratike.

Disa shembuj nga e kaluara e afërt tregojnë se, për fat të keq, ka pasur pasoja të dukshme dhe të padëshiruara për shkak të përdorimit të pakontrolluar të forcës policore.⁹ Komuniteti përballet vazhdimisht me nevojën e forcimit të policisë dhe rrezikun që vetë policia, në vend që të sigurojë mbrojtje, të kalojë dhe të bëhet kërcënim. Kjo kontradiktë midis nevojës së shoqërisë për të forcuar policinë dhe në të njëjtën kohë, për ta kufizuar dhe kontrolluar atë, është paraqitur më së miri në raportin e vitit 1962 të Komisionit Mbretëror Britanik, i shprehur përmes fjalëve: “Shoqëria dëshiron që policia të jetë e fortë dhe efektive në mbrojtjen e rendit publik dhe parandalimin e krimit, por gjithashtu kërkon që pushteti i nëpunësve policorë të kontrollohet dhe kufizohet në mënyrë që të mos kufizohet liria personale. Rezultati është një kompromis. Policia duhet të jetë e fortë, por jo e dhunshme; duhet të jetë efektive, por jo ndërhyrëse; të jetë forcë e paanshme në mjedisin politik të shoqërisë, por edhe t'i nënshtrohet një shkalle kontrolli nga persona që nuk kërkohet të jenë të paanshëm, por që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e policisë”.¹⁰

⁸ ibid, f. 305.

⁹ Media civile, lajm, “Brutaliteti i regjimit në veprim - Si rrahën NjSSH-ja studentët në leximore!” [Режимската бруталност на дело – Како ЕБР тепаше студенти во читална!] <https://civilmedia.mk/rezhimskata-brutalnost-na-delo-kako-ebr-tepashe-studenti-vo-chitalna/>

¹⁰ Millosavljeviq, Bogoljub. “Shkenca e Policisë” [Nauka o policiji], Akademia Policore, Beograd, 1997, f. 300.

Fragmente nga diskutimet e grupeve të fokusit me qytetarët

“Dua të them vetëm për qasjen e policisë ndaj komunitetit rom, është shumë diskriminuese, qasja është shumë e keqe, ndaj i tërheqin zvarrë kur shkojnë, vitin e kaluar mendoj, policia ka gjuajtur një plumb në mes të lagjes së romëve, në një rrugë të mbushur me njerëz, me fëmijë, kanë qëlluar një plumb nga afër dhe nuk kanë marrë përgjegjësi për këtë...Sepse jemi romë” – bashkëbisedues, GF Shtip.

“Ne shohim llogaridhënie për disa, pra, shkelje paushall, shohim llogaridhënie, këtu në buletin që publikojnë, se dikush ka hyrë, ka vjedhur një biçikletë, dikush është kapur me një gram marihuanë...Rrallë dëgjojmë ndonjë raport nga policia për krime të rëndësishme dhe të mëdha” – bashkëbisedues, GF Strumicë.

Për të qenë efektiv në zbatimin e mbikëqyrjes dhe kontrollit, komuniteti ka nevojë për mekanizma të qeverisjes efektive.

KONTROLLI I BRENDSHËM MBI PUNËN E POLICISË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Në organizatën policore në Republikën e Maqedonisë së Veriut ekziston rregullim hierarkik, i cili bazohet në parimet e ligjshmërisë, efikasitetit, bashkimit të udhëheqjes dhe zbatimit të ligjit me forcë minimale. Çdo nëpunës policor është përgjegjës për zbatimin e përgjegjësive policore dhe përgjegjësia rritet në raport me avancimin në hierarkinë e organizatës policore.

Vlerësimi mesatar nga intervistat e kryera me nëpunësit policorë në tetë sektore të brendshme

“Policia në Maqedoni është llogaridhënëse në punën e saj” - nota mesatare: 3,95
(në shkallën 1 deri në 5, ku 1 është nota më e ulët dhe 5 është nota më e lartë).

Devijimet dhe sjelljet e pahijshme në organizatën e policisë korrigjohen me rregullat e profesionit dhe me vendimet e drejtuesit. Rastet e sjelljeve më të rënda të paligjshme dhe joetike të policisë hetohen dhe dokumentohen nga Sektori i Kontrollit të Brendshëm, Hetimit Kriminal dhe Standardeve Profesionale.

Në kuadër të MPB-së, Sektori i Kontrollit të Brendshëm ekziston për më shumë se dy dekada dhe është themeluar me qëllim të përmirësimit të profesionalizmit të policisë. Fuqia e tij zgjerohet që në fillim duke shtuar detyra për të dokumentuar sjelljen e pahijshme të policisë dhe duke ndërtuar kulturë të vendosjes dhe përmirësimit të standardeve profesionale - në nivel qendror dhe lokal.

Më pas, kompetenca e Sektorit u plotësua me ngritjen e institutit të “hetimeve penale”, që synon përgjimin e sjelljeve kriminale të individëve – nëpunës policorë dhe dokumentimin e sjelljeve kriminale.

Të dhënat e punës së Sektorit të Kontrollit të Brendshëm, Hetimit Penal dhe Standardeve Profesionale nga Raporti Vjetor i Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin 2021¹¹

Aktivitetet e Sektorit të Kontrollit të Brendshëm, Hetimit Penal dhe Standardeve Profesionale	2020	2021
Masat e detyrueshme për fillimin e procedurës për vendosjen e përgjegjësisë disiplinore ndaj punonjësve	388	307
Masa e theksuar “tregues”	185	232
Masa e shqiptuar për hapjen e procedurës së dëmshpërblimit (përgjegjësi materiale)	21	15
Masa e detyrueshme për largim, përkatësisht pezullim nga puna deri në përfundim të procedurës disiplinore	24	39
Punonjësit dërgohen në kontroll psikologjiko-psikiatrik	52	34
Punonjësve të cilëve u janë konfiskuar armët	48	33
Ankesat e pranuar dhe përgjigjet nga Avokati i Popullit	30	43
Përgjigjet e marra me shkrim nga OJQ-të	19	15
Rastet e hetuara ku tregohen tejkalimi i autorizimeve dhe keqpërdorimi i pozitës zyrtare	1409	1239
Ankesat me shkrim	608	562
Ankesat e paraqitura gojarisht	232	262
Parashtresat anonime	259	97
Ankesat e dorëzuara në numrin e telefonit 199	-	1
Ankesat e paraqitura përmes avokatëve të autorizuar nga qytetarët	72	68
Ankesat e paraqitura nëpërmjet personave juridikë	-	47
Materialet zyrtare të marra nga paraqitjet e brendshme dhe njohuritë e veta	220	214
Kallëzimet penale të paraqitura	19	17
Njoftimi i PP-së (Prokurorisë Publike) për njohjen dhe veprimin e saj	101	81
Njoftimet e dorëzuara me kërkesë të PP-së	88	150

¹¹ Raporti Vjetor i MPB-së për vitin 2021.

Megjithatë, qytetarët nuk kanë shumë ndërveprim apo përvojë me mekanizmin e kontrollit të brendshëm. Për publikun mbetet e panjohur se si kryhen hetimet penale nga Sektori i Kontrollit të Brendshëm.

Pjesë nga diskutimet e grupeve të fokusit me qytetarët

“

“Kam dëgjuar për kontrollin e brendshëm të policisë. Njëherë një polic më tha: "Këta në Shkup që janë, Kontrolli i Brendshëm, na shohin si armiq." Mjafton një akt dhe me siguri do të dënoheni... ata janë armiqtë tanë kryesorë” – bashkëbisedues, FG Shtip.

Pas kallëzimit të dorëzuar në Kontrollin e Brendshëm të MPB-së, një qytetar i Shkupit ka marrë përgjigje nga një polic: “Kot e keni denoncuar, nuk do ta dënojmë. Tërhiqeni kallëzimin” – bashkëbisedues, FG Shkup.

”

Gjithashtu, publiku profesional vazhdimisht përpiqet për pavarësi më të madhe të Sektorit, veçanërisht në drejtim të përzgjedhjes dhe emërimit të drejtuesit, gjë që vendos ministri i punëve të brendshme.¹²

¹² Stojanovski, Trpe. “Avokati i Popullit+ Mekanizmi i Kontrollit Policor n Republikn e Maqedonis s Veriut - Mendim Juridik” [Омбудсман + Механизам за контрола над полицијата во Република Северна Македонија – правно мислење], Komiteti i Helsinkit n Maqedoni, Shkup, 2021

KONTROLLI I JASHTËM MBI PUNËN POLICORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Mekanizmi i kontrollit të jashtëm të policisë është mjet i rëndësishëm për korrigjimin e sjelljes së policisë kundër ligjit dhe një mundësi për të drejtuar veprimet e ardhshme të policisë, të cilat do të kenë mbështetjen e komunitetit. Një hap i rëndësishëm përpara në Republikën e Maqedonisë së Veriut është bërë në vitin 2016, kur është miratuar koncepti i krijimit të njësisë speciale në PP, e cila do të veprojë për krimet e kryera nga nëpunësit policorë (dhe nëpunësit e tjerë me kompetenca policore). Në vitin 2018 u bënë ndryshime ligjore dhe u krijua një parakusht për nisjen e konceptit të kontrollit të jashtëm të policisë. Ky sektor në kuadër të PP-NKOK (Prokuroria Publike e Ndjekjes së Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit) ka filluar punën në dhjetor të vitit 2018.

Vitet e para të punës së Njësisë së Specializuar për Hetimin dhe Ndjekjen e Krimeve të kryera nga persona me kompetenca policore dhe pjesëtarë të Policisë së Burgjeve në PP, tregon aktivitetin dhe efikasitetin e madh në zbulimin, dokumentimin, ndjekjen dhe gjykimin e krimeve të kryera nga nëpunësit policorë.

Përgjigje ndaj kërkesës për qasje në informacionet me karakter publik për punën e Njesisë së Specializuar për vitin 2021

Gjatë vitit 2021, në regjistrin “KOPS” (Aktakuza Penale Kundër Nëpunësve Policorë) janë ngritur 125 kallëzime (lëndë) ndaj 279 nëpunësve policorë dhe pjesëtarëve të policisë së burgjeve, nga të cilat 91 kallëzime (lëndë) penale për 217 persona janë nga viti 2021, 31 kallëzime (lëndë) penale për 57 persona janë nga viti paraprak 2020, 2 kallëzime (lëndë) penale për 4 persona janë të vitit 2019 dhe 1 kallëzim (lëndë) për 1 person nga viti 2018.

- Për 32 persona janë dorëzuar aktakuza në Gjykatën Themelore Penale Shkup;
- për 20 persona në Gjykatën Themelore Penale Shkup janë dorëzuar propozime për dhënie të urdhërit penal;
- janë miratuar vendime për hedhjen e kallëzimit penal për 122 persona;
- për 15 persona kallëzimet (lëndët) janë dorëzuar në veprimin kompetent të një prokurorie tjetër themelore publike;
- për 10 persona janë miratuar urdhra për zhvillimin e procedurës hetimore;
- kërkesat për zgjidhjen e konfliktit të juridiksionit janë paraqitur për 4 persona.

Aktgjykimet e shkallës së parë janë shqiptuar për 50 persona, prej të cilëve 36 janë dënuar me masë alternative me kusht, 6 janë dënuar me burg, 4 persona janë dënuar me gjobë dhe 4 persona janë liruar nga akuzat.

Gjatë vitit 2021, në regjistrin “KOPS” (Aktakuza Punuese Kundër Nëpunësve Policorë) janë trajtuar 167 çështje me 338 persona, nga të cilat 164 raste për 330 persona me kompetenca policore dhe 3 raste me 8 persona pjesëtarë të policisë së burgjeve. Janë 68 raste për 134 persona që kanë mbetur në punë në vitin 2020 dhe 2 raste për 4 persona që kanë mbetur në punë në vitin 2019 ose në total në vitin 2021 janë 237 raste për 476 persona.

- Me vendim të Prokurorit Publik janë përfunduar 168 lëndë për 341 persona (janë miratuar rezoluta);
- Në funksion kanë mbetur 69 raste për 135 persona.

Komponenti i dytë i këtij mekanizmi përbëhet nga krijimi i një njësie të posaçme në kuadër të Avokatit të Popullit, ku do të marrin pjesë tre zyrtarë nga Zyra e Avokatit të Popullit dhe tre përfaqësues të shoqërisë civile, i dyti i përzgjedhur në konkursin e shpallur nga Kuvendi.

Me themelimin e Njesisë së Avokatit të Popullit, ky mekanizëm është zbatuar pjesërisht, ndonëse ende ka vështirësi për të filluar punën në kuptimin e vërtetë, për shkak të pozicionit asimetrik të përfaqësuesve të sektorit civil, mandati i të cilëve është i kufizuar në një vit, në vend të tre viteve të parashikuara. Shqetësimi i dytë i madh është përpjekja e Avokatit të Popullit në vitin 2020 që t'u imponohet përfaqësuesve të shoqërisë civile - anëtarë në organin e kontrollit të jashtëm, dhe t'i detyrojë në punën e organit.¹³

Nga Raporti Vjetor për punën e Avokatit të Popullit për vitin 2021¹⁴

Gjatë vitit 2021, në fushën e kompetencave policore janë regjistruar gjithsej 117 ankesa, 10% më pak se një vit më parë, kur ishin regjistruar 130 ankesa. Në këtë vit raportues, si dhe në vitin paraprak, qytetarët janë ankuar për mosmarrje të masave pas kallëzimeve penale dhe kallëzimeve të tjera (42), masa të pamjaftueshme të marra nga policia për zbulimin dhe kapjen e autorëve të krimeve (12), përfshirë zbulimin e vrasjeve dhe vjedhjeve të rënda, për mosdhënie të ndihmës dhe mbrojtjes policore të qytetarëve (12), si dhe sekuestrim dhe kthim të paarsyeshëm të sendeve në procedurë policore (11). Disa nga ankesat e parashtruara (15) kanë të bëjnë me privimin e pabazuar ose të kundërligjshëm nga liria, kapjen e paarsyeshme dhe thirrjen, si dhe ndalimin e pabazuar në stacion policor, shkeljen e të drejtave në procedurën e kundërvajtjes (9) dhe ankesat në të cilat qytetarët kanë kërkuar vetëm këshilla juridike (8).

¹³ "Demantim i ri për Ixhet Memetin, tashmë nga anëtarët e "Avokati i Popullit +" [Нов демант до Ицет Мемети, сега од членовите на „Омбудсман+“], <https://360stepeni.mk/nov-demant-do-idhet-memeti-sega-od-chlenkite-na-ombudsman/>

¹⁴ Raporti vjetor i punës së Avokatit të Popullit për vitin 2021.

<http://ombudsman.mk/%D0%9F%D0%BE%D1%87%D0%B5%D1%82%D0%BD%D0%B0/%D0%9D%D0%9F%D0%9C/%D0%98%D0%97%D0%92%D0%95%D0%A8%D0%A2%D0%90%D0%98/%D0%93%D0%BE%D0%B4%D0%B8%D1%88%D0%BD%D0%B8.aspx>

PËRFUNDIMET

Sipas rezultateve të sondazhit të opinionit publik, përqindja e qytetarëve (1.7%) që kanë pasur nevojë të paraqiten në Kontrollin e Brendshëm të Policisë është e vogël. Nga ata që raportuan në Kontrollin e Brendshëm, 2/3 mendojnë se nuk kontribuon në uljen e korrupsionit dhe joprofesionalizmit në organizatë.

Në përgjithësi, ky konstatim duhet të konsiderohet vetëm si një tregues, duke pasur parasysh masën e vogël statistikore dhe si bazë për përgjithësime më të gjera.

Gjatë diskutimeve me qytetarët, mendimet dhe pikëpamjet e tyre u mbuluan plotësisht dhe ndryshe nga intervistat me punonjësit e policisë, ky grup i larmishëm qytetarësh diskutuan dhe analizuan hapur punën e policisë në komunitetet e tyre lokale, duke u fokusuar veçanërisht në transparencën, vendimmarrjen gjithëpërfshirëse, konceptin e “policisë në komunitet”, llogaridhënien e policisë dhe efektivitetin e saj në komunitetet lokale.

Në përgjithësi, për pjesëmarrësit e grupit të fokusit, përkufizimi i transparencës dhe llogaridhënies është mjaft i ngjashëm. Disa nga bashkëbiseduesit besojnë se policia është përgjegjëse për informacionin që shpërndan në rrjetet e saj sociale dhe në faqen e internetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Disa nuk e konsiderojnë të plotë llogaridhënien e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Sa i përket llogaridhënies së policisë, të pranishmit vlerësojnë se Ministria e Punëve të Brendshme është larg atij koncepti të hapur dhe demokratik të punës dhe besojnë se qytetarët nuk janë mjaft të informuar për punën e policisë.

Sipas tyre, **policia llogaridhënëse** do të thotë që Ministria e Punëve të Brendshme rregullisht të tregojë se çfarë ka bërë, çfarë i ka thënë publikut dhe qytetarëve dhe si i kanë marrë ato informacione. Sa i përket mekanizmit të kontrollit të jashtëm të policisë, shumica e tyre nuk kanë dëgjuar për këto mundësi. Shumica e njohin mekanizmin e kontrollit të brendshëm në polici. Perceptimi mbizotërues është se mekanizmi i kontrollit të jashtëm policor nuk mund të funksionojë në mënyrë transparente dhe profesionale nëse është nga Maqedonia e Veriut.

Të pyetur rreth **mekanizmit të jashtëm të kontrollit të punës policore**, disa nga bashkëbiseduesit më së shumti e barazojnë atë me OSBE-në, si instrument që realizon aktivitete që MPB-ja nuk mund t'i realizojë dhe zbatojë. Një pjesë tjetër e bashkëbiseduesve, nga ana tjetër, nuk kanë dëgjuar për mekanizmin e jashtëm të kontrollit të punës policore dhe në përgjithësi e lidhin me mekanizmin e MPB-së për kontroll të brendshëm. Të pyetur se si duhet të duket një mekanizëm i jashtëm, diskutuesit thanë se ai duhet të jetë një organ i pavarur, civil, i cili duhet të funksionojë me ligj dhe të jetë një trup i njerëzve që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut dhe sigurisë dhe ata kontrollojnë se si vepron policia.

Fragment nga Doracaku i Punës Policore Demokratik nga Këshilltari i Lartë i Policisë së Sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së

Pa mekanizma mbikëqyrës të jashtëm, udhëheqësit e policisë nuk mund të hapnin hetime apo të na dënonin në rastet e tejkalimit të autorizimeve, duke çuar në kontrollin e brendshëm joefektiv. Mekanizmat e jashtëm të mbikëqyrjes mund të arrijnë paanshmëri më të madhe (të paktën në sytë e publikut) kur hetohen akuzat serioze kundër policëve. Përveç kësaj, këto mekanizma mund të krijohen më mirë për të inkurajuar nëpunësit policorë që të paraqesin prova kundër nëpunësve të tjerë dhe në veçanti kundër eprorëve.

Të paktët qytetarë të përfshirë me grupet e fokusit, të cilët kishin përvojë me kontrollin e brendshëm, besojnë se ky mekanizëm funksionon si mjet represiv ndaj nëpunësve policorë. Këta thonë se kontrolli i brendshëm në polici perceptohet si një aktivitet i ndërmarrë nga qytetarët, i cili mund të ndikojë drejtpërdrejt në rrezikimin e vendit të punës. Nga ana tjetër, një nga bashkëbiseduesit në diskutimet me qytetarët theksoi se mekanizmi i kontrollit të brendshëm funksionon mirë, në një institucion të caktuar kanë kërkuar të gjithë dokumentacionin e duhur, por nuk janë informuar për rezultatin e procedurës.

Sa i përket **luftës kundër korrupsionit** në MPB, qytetarët vlerësojnë se është shumë e vështirë për t'u realizuar, sepse ka individë që duan ta pengojnë proqesin dhe duhet të vendoset aksion sistematik dhe i koordinuar ndërinstytucional për luftimin e korrupsionit në polici.

Policia është manifestimi më i dukshëm i organeve qeveritare përgjegjëse për sigurinë publike.

Për të forcuar sundimin e së drejtës, reforma policore është thelbësore si fushë prioritare për efikasitet më të madh të komunitetit dhe përparim të mëtejshëm drejt anëtarësimit në BE.¹⁵

Nga ana tjetër, roli i Këshillit të Europës është shumë i rëndësishëm për forcimin e mëtejshëm të mekanizmit të kontrollit të jashtëm policor. Një hap përpara është bërë në zotërimin e njohurive bazë të funksionimit të mekanizmit të jashtëm. Megjithatë, nevojiten ekspertizë dhe trajnime të mëtejshme për harmonizimin dhe funksionimin e plotë të mekanizmit të kontrollit të jashtëm.

Së fundi, organizata e policisë në një shoqëri demokratike mund të njihet nga gatishmëria dhe pranimi i kontrollit dhe mbikëqyrjes së jashtme, si dhe nga shkalla e hapjes për të bashkëpunuar në këto kontrole. Shumica e OShC-ve me afinitete mbikëqyrëse merren me ankesa kundër policisë. Megjithatë, shkalla e përfshirjes së tyre në zgjidhjen e ankesave ndryshon në mënyrë të konsiderueshme. Përderisa disa shoqata mbikëqyrëse janë përgjegjëse për marrjen dhe hetimin e ankesave - ndonjëherë vetëm në rastet e keqsjelljes serioze ose kur duket se ka mospërputhje në kontrollin e brendshëm - OShC-të e tjera janë të kufizuara në monitorimin dhe shqyrtimin e hetimeve të kryera nga vetë shërbimet. Në mënyrë të ngjashme, përderisa disa organe nuk kanë ndikim mbi masat për të tejkaluar autoritetin e tyre, të tjerët mund të rekomandojnë masa disiplinore dhe madje mund të kenë fuqinë për të vendosur sanksione.¹⁶

¹⁵ Shilston, Timothy. "Democratic policing, community policing and the fallacy of conflation in international police development missions", *International Journal of Police Science & Management* 2015, Vol. 17(4), f. 207–215

¹⁶ "Doracak për Punën Policore Demokratike nga Këshilltari i Lartë i Policisë së Sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së" [Прирачник за демократско полициско работење од Вишиот полициски советник на Генералниот секретар на ОБСЕ], Vjenë, maj 2008, edicioni i dytë, f. 33, <https://www.osce.org/files/f/documents/f/f/109907.pdf>

